**VENDIM**
**Nr. 99, datë 26.2.2014**

# PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA AMBIENTEVE, NGA NJËSIA E MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT TE MINISTRIA E FINANCAVE, PËR AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të disa ambienteve, nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit te Ministria e Financave, për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Financave dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**


PLANIMETRIA E KATIT TE PARE (SHK. 1:100)
KUOTA + 3.50
(MBI DYQANE)


PLAN VENDOSJA E GODINES NE PRONEN
E FAMILJES SELFOLLARI
SHK 1:500
MIRATOHET
PER K.R.T. E BASHKISE
KRYETARI
RRUGA 'A. FRASHERI'
RRUGA 'PERLAT REXHEPI'
RR. 'VASO PASHA'
5KT
6KT
9KT
8KT
2KT
10KT
3KT
24 01 6

1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni qendror: Ministria e Financave

Fusha e përdorimit të pronës: administratë

| **Nr.** | **A** | | | | **B** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastrale dhe indeksi i hartës** | **Numri i pasurisë** | **Lloji i pasurisë** | **Emri i pronës (adresa)** | **Sipërfaqja e pronës** | | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Institucioni me përgjegjësi administrative** | **Institucioni që përdor pronën** | **Të dhëna të tjera** |
| | | | | | **Sipërfaqja totale $m^2$** | **Nga kjo: ndërtesë $m^2$** | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | | 3876 | Ndërtesë | Rruga "Perlat Rexhepi", pallati i ri 10-katësh, Tiranë, kati i parë (i banueshëm) i përbërë nga 6 (gjashtë) zyra 4 (katër) ballkone dhe 2 (dy) banja, Tiranë | 211,00 | 211,00 | Zyra pune | Ministria e Financave | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara | |